



Në mbështetje të nenit 64.2 pika (a) dhe (b) dhe neneve 82, 83, 84, 85, 86, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) dhe nenit 20 dhe 29.2 Ligjit nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023, miraton këtë:

**RREGULLORE NR. 12/2023**  
**VOTIMI, NUMËRIMI NË VENDVOTIM DHE MENAXHIMI I**  
**QENDRËS SË VOTIMIT**

**Neni 1**  
**Fushëveprimi**

Kjo Rregullore përcakton procesin e votimit, numërimit brenda Vendvotimit (VV), menaxhimin, sigurimin e VV, rolin e vëzhgueseve, librin e votimit, materialet e fushatës zgjedhore dhe materialet për informim të votuesve, procedurat para fillimit të votimit, të drejtën e votës, dokumentet e pranueshme të votimit, votimin rregullt, votimin me kusht, kompetencat e menaxherit dhe stafit teknik të Qendrës së Votimit (QV), procesin e numërimit të rezultateve deri në fazën e pranim-dorëzimit të materialit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).

**Neni 2**  
**Lokacionet e QV dhe VV**

1. Në bazë të rekomandimit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), KQZ publikon lokacionet e të gjitha QV, jo më vonë se dyzet (40) ditë para zgjedhjeve.
2. Mundësisht, asnjë votues nuk duhet të udhëtojë më shumë se 3 km deri në VV e tij/saj.
3. Ndryshimet e lokacioneve të QV lejohen nga KQZ, vetëm në rast të *forcës madhore* ose për shkaqe të tjera objektive dhe të paparashikuara, që do ta bënin një QV të papërshtatshme për qëllime votimi.
4. Nëse lokacioni i QV ndryshohet, KKZ duhet t'i njoftojë votuesit për atë ndryshim përmes mediave. Përveç kësaj, KKZ do të vendosë një njoftim në lokacionin fillestar të QV, me të cilin i njofton votuesit për lokacionin e ri të QV.
5. QV nuk duhet të vendoset në një objekt fetar, ndërtesë që është pronë ose seli e ndonjë subjekti politik.

6. VV vendosen duke filluar në katin përdhese, në një vend të përshtatshëm për hyrje-dalje, për t'u mundësuar votuesve të krijojnë rresht dhe të qëndrojnë në të, dhe kur është e mundur, vendi për hyrje-dalje të jetë i rrafshët, ashtu që personat me aftësi të kufizuara të mund të hyjnë dhe të dalin në mënyrë të papenguar.
7. VV duhet të jetë mjaftueshëm i madh, që të sigurojë zhvillim të rregullt të votimit duke vendosur të gjitha tavolinat e punës si janë definuar në këtë Rregullore dhe duke siguruar fshehtësinë e votimit, shikimin dhe kontrollin e lirë të kutisë së votimit dhe qasje të papenguar për vëzhguesit.
8. Në VV dhe në QV, gjatë ditës së zgjedhjeve mund të jenë të pranishëm vetëm personat e autorizuar si në vijim:
  - 8.1. Personat me qëllim të votimit;
  - 8.2. anëtarët e KVV dhe stafi i QV;
  - 8.3. anëtarët e KQZ dhe SKQZ;
  - 8.4. anëtarët e KKZ që veprojnë në komunën e tyre;
  - 8.5. vëzhguesit e akredituar;
  - 8.6. policia, kur thirret për të vendosur rregull;
  - 8.7. përkthyesit për personat e shënuar në nënparagrafët 8.3, 8.5 dhe 8.6 të këtij paragrafi.
9. Në çdo QV duhet të ketë edhe shabllone me alfabetin e brajl-it dhe KVV të trajnuar për votimin e personave të verbër, të cilët do t'u shërbejnë votuesve të verbër në atë QV.

### **Neni 3**

#### **Këshilli i Vendvotimit**

1. Në çdo VV duhet të caktohet një KVV, që udhëheq dhe mbikëqyrë procesin e votimit dhe numërimit në VV gjatë ditës së zgjedhjeve, në pajtim me nenin 2 të Rregullores Nr. 11 për KVV.
2. Kryesuesi i KVV është përgjegjës për të gjitha aktivitetet në VV e tij/saj prej procesit të pranimit e deri sa të bëhet dorëzimi i materialit tek Zyrtari Ekzekutiv i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (ZEKKZ).

## **Neni 4**

### **Përbërja dhe menaxhimi i QV**

1. Në QV gjatë ditës së zgjedhjeve mund të jenë të pranishëm personat e autorizuar si në vijim:
  - 1.1. Personat me qëllim të votimit;
  - 1.2. anëtarët e KVV dhe stafi i QV;
  - 1.3. stafi i KQZ dhe SKQZ;
  - 1.4. anëtarët e KKZ që veprojnë në komunën e tyre;
  - 1.5. vëzhguesit e akredituar;
  - 1.6. policia, kur thirret për të vendosur rregull;
  - 1.7. përkthyesit për personat e shënuar në nënparagrafin 1.3., 1.5., 1.6. të këtij neni.
2. Personeli i QV përbëhet nga:
  - 2.1. Menaxheri i QV;
  - 2.2. personeli teknik i QV;
  - 2.3. personeli i tavolinës ndihmëse.
3. Menaxheri i QV është përgjegjës për:
  - 3.1. Organizimin dhe planifikimin e të gjitha aktiviteteve teknike në QV
  - 3.2. pranimin e pakos së materialeve të QV dhe sigurimin e materialeve për votim;
  - 3.3. orientimin, qarkullimin dhe qasjen e votuesve në QV;
  - 3.4. raportimin tek KKZ për mbarëvajtjen dhe statistikat e votimeve përkatëse në kuadër të QV;
4. Çdo QV duhet të ketë personelin teknik që i ndihmon menaxherit të QV në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.
5. Çdo QV duhet të ketë personelin e tavolinës ndihmëse, i cili është përgjegjës për:
  - 5.1. Orientimin e votuesve në vendvotime, sipas LPV;

5.2. raportimin e pjesëmarrjes së votuesve;

5.3. raportimin e rezultateve preliminare, bazuar në të dhënat e KVV, sipas udhëzimeve nga KQZ.

## **Neni 5**

### **Përgatitja teknike e VV**

1. Përgatitja dhe rregullimi i VV bëhet një ditë para ditës së zgjedhjeve.
2. Mënyra e organizimit të VV duhet të mundësojë qarkullim të lirshëm të votuesve dhe të ofrojë transparencë:
  - 2.1. Ulëset rregullohen në atë mënyrë që anëtarët e KVV dhe vëzhguesit e zgjedhjeve të mund ta shikojnë tërë procesin e votimit dhe t'i shohin qartë kutitë e votimit gjatë gjithë kohës;
  - 2.2. Kabinat e votimit vendosen në atë mënyrë që të sigurohet që votuesi të mund të votojë në fshehtësi.

## **Neni 6**

### **Roli i Vëzhguesve**

1. Vëzhguesit mund të vëzhgojnë procesin e hapjes së vendvotimit, votimin, numërimin, paketimin dhe dorëzimin e materialit nga VV te KKZ dhe nga KKZ në QNR, me përjashtim të shënimit të fletëvotimit nga votuesi.
2. Jo më shumë se një vëzhgues nga organizata e njëjtë e akredituar mund të jetë i/e pranishëm në të njëjtën kohë në VV.
3. Me pajtimin e anëtarëve të KVV, kryesuesi i KVV, nëse vlerëson se numri i vëzhguesve të akredituar të pranishëm në VV është duke penguar procesin e votimit apo numërimit, ai/ajo duhet t'i urdhërojë vëzhguesit që ta lirojnë VV, në mënyrë që në të njëjtën kohë mos të ketë më shumë se një vëzhgues nga një organizatë.

## **Neni 7**

### **Libri i Votimit**

1. Çdo VV ka librin e votimit në të cilin shënohen të gjitha ngjarjet në lidhje me mbarëvajtjen e procesit të votimit dhe numërimit në VV gjatë ditës së zgjedhjeve.
2. Vetëm kryesuesi i KVV, anëtarët e KVV dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm, lejohen të bëjnë shënime në librin e votimit.

3. Nëse votuesi ka ankesë në lidhje me ndonjë aktivitet brenda VV, ai/ajo mund të kërkojë nga Kryesuesi i KVV, regjistrimin e ankesës së tij/saj në librin e votimit. apo të kërkojë formularin e ankesës, dhe ta dorëzojë ankesën në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP).
4. Kryesuesi i VV duhet t'i informojë të gjithë vëzhguesit e akredituar të pranishëm, që nëse largohen nga VV para përfundimit të numërimit, pasi të mbyllet procesi i votimit, atyre nuk u lejohet kthimi në VV, përveç në rast se kërkohet zëvendësim nga organizata e njëjtë.

## **Neni 8** **Siguria në VV**

1. Kryesuesi i KVV, me ndihmën e të gjithë anëtarëve, duhet të sigurojë qetësi dhe siguri në procesin e votimit brenda VV. Rendi në rresht para VV do të mbahet nga një anëtar, që caktohet si kontrollues i rreshtit.
2. Në rast se cenohet siguria dhe mbarëvajtja e procesit zgjedhor brenda VV, kryesuesi i KVV duhet të kërkojë ndihmë të menjëhershme nga policia. Ky rast duhet të shënohet menjëherë në librin e votimit.
3. Në rast se çrregullimi bëhet kërcënim serioz për integritetin e procesit të votimit ose për njerëzit brenda VV, kryesuesi i KVV mund të vendosë ta pezullojë votimin dhe ta mbyllë VV, derisa të rivendoset rendi. Kryesuesi menjëherë informon KKZ dhe shënon ngjarjen në Librin e Votimit, duke përfshirë kohën gjatë të cilës është pezulluar votimi. Gjatë kohës së pezullimit, në VV qëndrojnë anëtarët e KVV dhe vëzhguesit, nëse nuk janë shkaktarë të çrregullimit. Kryesuesi dhe anëtarët kujdesen për materialet sensitive.
4. KQZ miraton planin operativ të sigurisë.

## **Neni 9** **Materiali i fushatës së zgjedhjeve dhe materiali për informim të votuesve në VV dhe në QV**

1. Së paku 24 orë para fillimit të votimit, KVV dhe menaxheri i QV do të largojë çfarëdo lloj materiali të fushatës zgjedhore, në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të QV, duke përfshirë rrethojat. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialin e fushatës zgjedhore deri 24 orë para fillimit të votimit, ose janë gjetur duke postuar materialin e fushatës zgjedhore pas afatit kohor të caktuar, KVV duhet të raportojë në PZAP, menjëherë pasi që shkelja është paraqitur.
2. Asnjë informatë e fushatës zgjedhore nuk do të transmetohet në asnjë pajisje komunikimi në VV apo QV, dhe as në distancë të dëgjueshme. Një veprim i tillë raportohet nga KVV

në PZAP menjëherë pasi që shkelja të jetë bërë.

3. Çdo material i shtypur i zgjedhjeve, i përgatitur nga KQZ, që ka listuar të gjitha subjektet e certifikuara politike dhe të gjithë kandidatët e certifikuar, duhet të ekspozohet nëpër VV dhe në derën kryesore të hyrjes të çdo QV, për informim të votuesve.
4. Shenjat informuese në ndërtesë duhet të paraqesin qartë numrin e QV. Shenjat që i drejtojnë votuesit në VV ekspozohen në vende të dukshme brenda QV. Çdo VV shënohet qartë me shenja të cilat tregojnë numrin e VV dhe shkronjën fillestare të mbiemrit të atyre votuesve që janë të caktuar në atë VV.

## **Neni 10**

### **Procedurat para fillimit të votimit**

1. Deri në orën 06:00 në ditën e zgjedhjeve, në hapësirat e KKZ, kryesuesi i KVV dhe njëri nga anëtarët e KVV, i cili vepron si zëvendës kryesues gjatë gjithë procesit, kryen këto veprime:
  - 1.1. Kontrollon të gjitha materialet nga KKZ, duke përfshirë Listën Përfundimtare të Votuesve (LPV) dhe Listën Komunale të Votuesve (LKV) e zbrazët, zarfet e fletëvotimeve me kusht, fletëvotimet, kutitë e votimit, kabinat e votimit, llambën ultravjollce dhe ngjyrën e padukshme, vulën zyrtare të fletëvotimit, ngjyrën, mbushësit e ngjyrës, librin e votimit dhe materialin për zyrë;
  - 1.2. plotëson dhe nënshkruan formularin e dorëzimit-pranimit të materialit, kopja e të cilit është bashkangjitur në shtojcën I, duke vërtetuar numrin e fletëvotimeve, listën përfundimtare të votuesve (LPV) dhe materialin ekzistues;
  - 1.3. bartja e materialit në VV bëhet nën përcjellje të policisë.
2. Anëtarët e KVV duhet të jenë të pranishëm në VV së paku një orë para (orës 6:00) hapjes së votimit (orës 07:00).
3. Para hapjes së VV, kryesuesi i KVV:
  - 3.1. Informon KKZ për cilindo anëtar të KVV që mungon dhe të kërkojë zëvendësim. Nëse mungon kryesuesi, atëherë anëtari i KVV që vepron si zëvendës kryesues duhet ta zëvendësojë kryesuesin dhe të kërkojë nga KKZ që të sigurojë zëvendësimin për anëtarin e KVV. Një VV do të lejohet të hapet me një numër minimal prej tre (3) anëtarësh të KVV;
  - 3.2. verifikon dhe shënon numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pranuar në Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve (FPR), - shtojca II;

- 3.3. përgatitë dhe ekspozon kutinë e zbrazët të votimit në prani të anëtarëve të KVV dhe cilitdo vëzhgues të akredituar të pranishëm, pastaj kutinë e votimit e mbyll me shiritat mbyllës të siguruar për këtë qëllim, dhe të shënojë numrin serik të shiritave mbyllës të kutisë së votimit në FPR;
  - 3.4. shënon në librin e votimit emrat dhe numrat personal të letërnjoftimeve të gjithë anëtarëve të KVV dhe vëzhguesve të pranishëm;
  - 3.5. siguron se nuk ka material të fushatës, se është vendosur materiali për informim lidhur me votimin, sipas nenit 9 paragrafi 4, të kësaj Rregulloreje.
4. Nëse VV hapet me vonesë, kryesuesi i KVV menjëherë e njofton KKZ, e cila pastaj informon KQZ. Kryesuesi i KVV gjithmonë shënon kohën e hapjes së VV në librin e votimit, ndërsa në rast vonese shënon arsyen e vonesës në librin e votimit.

### **Neni 11**

#### **Orari i votimit**

1. Të gjitha VV duhet të hapen në orën 07:00 dhe të mbyllen në orën 19:00.
2. Askush nuk mund të votojë pas kohës së mbylljes së QV, përveç votuesve të cilët presin në radhë para VV në kohën e mbylljes.

### **Neni 12**

#### **Fshehtësia e votës**

1. Asnjë person nuk mund ta pengojë një votues nga ushtrimi i së drejtës së tij/saj për të votuar.
2. Asnjë person nuk lejohet të votojë në emër të një votuesi tjetër.
3. Çdo votues duhet të votojë në kabinën e votimit. Vetëm personi që voton lejohet të qëndrojë në kabinën e votimit.
4. Anëtarët e KVV nuk lejohet në asnjë mënyrë të ndikojnë në vendimin e votuesit.
5. Anëtarët e KVV sigurojnë që votuesi nuk shqetësohet nga askush gjatë votimit dhe që fshehtësia e votimit është siguruar plotësisht.
6. Anëtarët e KVV shpjegojnë procedurën e votimit, vetëm nëse u kërkohet nga votuesit, dhe atë sipas procedurave të votimit.

## **Neni 13**

### **Dokumentet e pranueshme të identifikimit**

1. Për qëllime të identifikimit të votuesve në LPV dokumentet e pranueshme të Republikës së Kosovës janë:
  - 1.1. Letërnjoftim i vlefshëm;
  - 1.2. pasaporta e vlefshme;
  - 1.3. leja e vlefshme e vozitjes.

## **Neni 14**

### **Votimi i rregullt**

1. Njëri nga anëtarët e KVV në VV, në hyrje do të kontrollojë secilin votues nëse ka njollë të ngjyrës së padukshme në gishtërinjtë. Cilido votues në gishtin e të cilit gjendet njolla e ngjyrës së padukshme, nuk do të lejohet të votojë.
2. Në VV kontrollohet nëse emri dhe mbiemri i votuesit gjendet në LPV:
  - 2.1. Nëse emri dhe mbiemri i votuesit gjendet në LPV, pa një shenjë ose shënim, votuesi duhet të udhëzohet që të nënshkruajë në LPV pranë emrit të tij/saj;
  - 2.2. nëse emri dhe mbiemri i votuesit nuk figuron në LPV, votuesi udhëzohet që ta vizitojë tavolinën ndihmëse të QV-së, për të mësuar se në cilin QV dhe VV është caktuar të votojë;
  - 2.3. nëse emri dhe mbiemri i votuesit gjendet në LPV me një shenjë ose shënim, atëherë votuesi udhëzohet të votojë vetëm me fletëvotim me kusht.
3. Votuesi i cili refuzon që të nënshkruhet në LPV, nuk do t'i jepet fletëvotimi dhe kontrolluesi i rreshtit do ta përcjellë atë jashtë VV. Ky rast duhet të shënohet në Librin e Votimit.
4. Pasi që votuesit t'i jetë dhënë fletëvotimi, ai/ajo udhëzohet të shkojë te njëra nga kabinat e votimit për të votuar në fshehtësi.
5. Në secilën kabinë të votimit gjendet nga një broshurë me emrat e kandidatëve për zgjedhjet e kuvendit komunal respektivisht të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës. Votuesi mund ta informojë kryesuesin e KVV nëse: mungon broshura, nëse faqet janë të grisura nga broshura, ose nëse në broshurë ka shënime të shkruara. Kryesuesi duhet të sigurojë broshurën e re.



6. Nëse votuesi e ka dëmtuar fletëvotimin e vet, ai/ajo duhet ta dorëzojë fletëvotimin e dëmtuar dhe të kërkojë një fletëvotim të ri të vulosur. Anëtari i KVV duhet ta bëjë me shenjë atë fletëvotim, duke shkruar “i dëmtuar” në anën e prapme të tij dhe duhet ta mbajë atë në një zarf të dizajnuar posaçërisht për këtë qëllim.
7. Pas votimit, votuesi duhet ta vendosë fletëvotimin në kutinë e votimit, ashtu që të mund të shihet nga personat e pranishëm dhe pastaj ai/ajo menjëherë largohet nga VV.
8. Në çdo VV duhet të ketë një kuti votimi për çdo nivel dhe lloj të zgjedhjeve. Në kutinë e votimit duhet të shënohet qartë lloji i zgjedhjeve dhe numri i VV, për të identifikuar qartë se për cilat zgjedhje janë të përcaktuara. Mbikëqyrësi i kutisë së votimit duhet të sigurojë që votuesit e vendosin vetëm fletëvotimin e duhur në kutinë përkatëse të votimit.
9. Mbikëqyrësi i kutisë së votimit nuk duhet ta lejojë asnjë votues që të largohet nga VV pa e vendosur fletëvotimin e pranuar në kutinë/të e votimit. Refuzimi i votuesit që të veprohet në përputhje me këtë kërkesë, konsiderohet shkelje e rëndë e dispozitave ligjore në fuqi.
10. Votimi në të njëjtën zgjedhje më shumë se një herë paraqet vepër penale dhe dënohet sipas Kodit Penal i Republikës të Kosovës.

## **Neni 15**

### **Votimi me kusht**

1. Votuesi në Kosovë, emri dhe mbiemri i të cilit nuk mund të gjendet në LPV, ose që emri i tij/saj gjendet në LPV me një shenjë ose shënim, lejohet të votojë me kusht në VV të posaçëm, me kusht që identiteti i tij/saj të mund të verifikohet, sipas nenit 14 të kësaj Rregulloreje.
2. Anëtari i KVV, shënon numrin personal, emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes së votuesit si dhe arsyen e votimit me kusht në LVK.
3. Pas shënimit të dhënave personale të votuesit në LVK, anëtari i KVV shkruan informatat e njëjta në zarfin e fletëvotimit me kusht, ndërkaq votuesi udhëzohet të nënshkruajë në LVK dhe ZFK pranë emrit të tij/saj. Nëse votuesi refuzon të nënshkruajë në LVK dhe ZFK, nuk i jepet fletëvotimi.
4. Procedurat e votimit vijojnë sipas procedurës së rregullt të votimit, e përcaktuar në nenin 14 të kësaj Rregulloreje.
5. Pas votimit, votuesi në prani të mbikëqyrësit të kutisë së votimit, e vendos fletëvotimin në një zarf të fshehtësisë dhe e mbyll atë. Votuesi, zarfin e fshehtësisë e vendos brenda zarfit të plotësuar të fletëvotimit me kusht, e mbyll dhe e vendos atë në kutinë e votimit.

## **Neni 16**

### **Votimi me asistencë**

1. Në raste të veçanta, kur votuesi i cili është me aftësi të kufizuar në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, mund të ndihmohet që të votojë nga një person i zgjedhur, nëse ai kërkon një ndihmë të tillë. Personi i zgjedhur e ndihmon vetëm një votues.
2. Për personin me aftësi të kufizuar, i cili nuk është në gjendje të mbajë lapsin, ndihmësi që e ndihmon votuesin, nënshkruan në LPV pranë emrit të votuesit, duke shkruar me shkronja të shtypit emrin e tij/saj pranë emrit ose hapësirës të votuesit që është asistuar.
3. Ndhmësit i lejohet që ta ndihmojë dhe informojë votuesin se si të votohet, votuesi voton vet. Ndhmësi obligohet të qëndrojë në një distancë nga votuesi, duke u larguar nga kabina e votimit, ashtu që të ruhet fshehtësia e votës.
4. Nëse votuesi me aftësi të kufizuar nuk është në gjendje të mbajë lapsin, atëherë ndihmësi mund ta ndihmojë në votim.
5. Nëse votuesi është i verbër, udhëzohet që të votojë në mënyrë të pavarur, përmes shabllonit me alfabetin e brail-it, që gjendet në QV.
6. Kryesuesi i KVV shënon në libër të votimit të dhënat personale të personave që kanë asistuar dhe të dhënat personale të votuesve që kanë votuar me asistencë dhe arsyen e saktë të votimit me asistencë.
7. Personi që asiston duhet të jetë i moshës 18 vjeç, dhe të ketë letërnjoftim të Republikës së Kosovës.
8. Keqpërdorimi apo tentimi për keqpërdorim i të drejtës për votim me asistencë, do të raportohet në organet e rendit.

## **Neni 17**

### **Mbyllja e Vendvotimit**

1. QV mbyllet në orën 19:00. Çdo person që gjendet në radhë brenda QV në momentin e mbylljes, i lejohet të votojë. Menaxheri i QV siguron që të gjithë ata që janë në radhë brenda QV hyjnë në VV. Personi që vjen pas mbylljes së QV, nuk mund të votojë.
2. Pasi të votojë personi i fundit në radhë, kryesuesi i KVV mbyllë VV, e mbyll vrimën në kapakun e kutisë së votimit me shiritin mbyllës, në atë mënyrë që kjo të mund të shihet nga vëzhguesit dhe në Librin e Votimit e shënon kohën e saktë të mbylljes.

## **Neni 18**

### **Procesi i numërimit në VV e rregullta**

1. Procedurat e numërimit të fletëvotimeve të rregullta udhëhiqen nga parimet: saktësia, transparenca, efikasiteti, integriteti dhe mbrojtja e sigurisë së votës.
2. Pasi të mbyllet vendvotimi, kryesuesi i KVV shënon në librin e votimit: emrat, numrat e letërnjoftimeve dhe numrat e akreditimit të gjithë vëzhguesve të pranishëm dhe i informon ata se nëse largohen nga VV para përfundimit të numërimit, nuk lejohen të kthehen.
3. Në prani të kryesuesit të KVV, anëtarët e KVV duhet të:
  - 3.1. Largojnë lapsat që janë përdorur gjatë procesit të votimit dhe materialet tjera që nuk nevojiten për numërim dhe vendosen në thes plastik, që mbyllet me shirita të sigurisë, numrat e cilëve shënohen në libër të votimit;
  - 3.2. organizojnë hapësirën e numërimit në atë mënyrë që, asnjë material të mos mbetet mbi tavolinë, ose në vendin e caktuar për numërim, përveç materialeve të nevojshme siç janë: letra e bardhë e zbrazët, libri i votimit dhe FPR.
  - 3.3. shpërndajnë lapsat dhe materiale tjera të dedikuara për numërim;
  - 3.4. llogarisin numrin e votuesve të nënshkrimeve në LPV dhe shënojnë numrin e tyre në FPR;
  - 3.5. numërojnë fletëvotimet e mbetura të papërdorura dhe shënojnë numrin e tyre në FPR;
  - 3.6. numërojnë fletëvotimet e dëmtuara, shënojnë numrin e tyre në FPR dhe i vendosin ato prapë në zarfin e caktuar për fletëvotime të dëmtuara;
  - 3.7. verifikojnë shiritat mbyllës dhe numrat e tyre serikë në kutinë e votimit, nëse këta numra janë të njëjtë me numrat e regjistruar në FPR.
  - 3.8. ndajnë mënjane fletëvotimet e papërdorura, zarfet me fletëvotime të dëmtuara, vulën zyrtare të fletëvotimit dhe LPV;
4. KVV heqë shiritat mbyllës dhe hapë kutinë e votimit. Në rast se në VV ka më shumë se një kuti të votimit, kutia e radhës hapet pas përfundimit të procesit të numërimit të kutisë paraprake.
5. Një anëtar i KVV e hap kutinë e votimit dhe i nxjerr fletëvotimet. Kryesuesi duhet të sigurojë që asnjë fletëvotim të mos mbetet brenda asaj kutie të votimit.

6. Kryesuesi dhe anëtarët e KVV numërojnë dhe klasifikojnë të gjitha fletëvotimet, sipas procedurave të miratuara nga KQZ.
7. Fletëvotimet rinumërohen nëse ka çfarëdo mospërputhje midis numrit të fletëvotimeve në kuti dhe numrit të nënshkrimeve në LPV, për :
  - 7.1. Më shumë se një (1), në 99 nënshkrime në LPV
  - 7.2. më shumë se dy (2), në më shumë se 100 nënshkrime në LPV.
  - 7.3. nëse edhe pas rinumërimit konstatohen mospërputhje përtej nivelit të tolerancës, sipas nën paragrafëve 7.1 dhe 7.2, kutia mbyllet, sinjalizohet dhe përcjellët në KKZ.
  - 7.4. pavarësisht nivelit të tolerancës sipas nën paragrafëve 7.1. dhe 7.2. e njëjta kuti e votimit sinjalizohet në KKZ për mospërputhjen.
8. Pas numërimit të gjitha fletëvotimeve nga kutia, numërohen votat për secilin subjekt politik.
9. Fletëvotimi i vlefshëm konsiderohet vetëm fletëvotimi i vulosur dhe i cili ka numrin serik të vendvotimit përkatës.
10. Vota është e vlefshme kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit:
  - 10.1. Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik. Nëse fletëvotimi është shënuar me më shumë se pesë kandidatë, e vlefshme do të konsiderohet dhe do të numërohet vetëm vota për subjektin politik;
  - 10.2. në zgjedhjet për kuvendin e komunës, fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik. Vota për subjektin politik konsiderohet votë për kandidatin e parë nga lista e kandidatëve nga ky subjekt politik. Nëse fletëvotimi është shënuar me më shumë se një (1) kandidat apo asnjë kandidat, e vlefshme do të konsiderohet dhe do të numërohet vetëm vota për subjektin politik..
11. Për zgjedhjet për kryetar të komunës, votë e vlefshme konsiderohet atëherë kur votuesi e ka shënuar vetëm një kandidat në fletëvotim.
12. Fletëvotimi do të konsiderohet i pavlefshëm, nëse:
  - 12.1. Në fletëvotim është shënuar më shumë se një kandidat;
  - 12.2. mënyra sesi është shënuar fletëvotimi, e bën të paqartë qëllimin e votuesit;

- 12.3. nuk është vulosur me vulën zyrtare të fletëvotimit apo kodi i VV në fletëvotim nuk i përket atij vendvotimi;
- 12.4. fletëvotimi është i zbrazët ose i pa shënjuar;
- 12.5. votuesi e shënon vetëm kandidatin/ët dhe jo subjektin politik.
13. Nëse anëtarët e KVV nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është fletëvotimi i vlefshëm apo i pavlefshëm, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkitazi me atë fletëvotim dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit.
14. Pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve të vlefshme që ka fituar secili subjekt politik. Në rast se me LZP nuk përcaktohet numërimi dhe verifikimi i votave të kandidatëve në qendra komunale të numërimit, atëherë zbatohen pikat e mëposhtme:
- 14.1. Në VV numërohen votat që u janë dhënë kandidatëve të secilit subjekt politik;
- 14.2. votat për kandidatët e subjekteve politike, nuk numërohen nga anëtarët e KVV të po atij subjekti;
- 14.3. votat e numëruara shënohen në fletat llogaritëse të kandidatëve, të cilat nënshkruhen nga lexuesi, regjistruesi dhe kryesuesi. Anëtarët e tjerë të KVV dhe vëzhguesit e pranishëm në VV, kanë të drejtë po ashtu të mbajnë shënime për numërimin dhe në rast gabimesh në numërim, të tërheqin vërejtjen;
- 14.4. kryesuesi plotëson Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) – shtojca IV, duke e plotësuar emrin e subjektit politik, dhe shënon numrin e votave të secilit kandidat të atij subjekti politik.
15. Pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve për zgjedhjet përkatëse, fletëvotimet pakëtohen, duke u ndarë në dengje sipas subjekteve politike. Nëse anëtarët e KVV konstatojnë se fletëvotimet në një kuti të caktuar të votimit janë për zgjedhje të tjera, ato fletëvotime numërohen dhe rezultati shënohet në FPR përkatëse. .
16. Paketimi i materialeve bëhet sipas procedurave të miratuara nga KQZ.
17. Anëtarët e KVV janë përgjegjës për saktësinë e rezultateve si dhe për plotësimin e saktë dhe rezultatet e shënuara në formularët përkatës.

## **Neni 19**

### **Përputhja e të dhënave të zarfeve me kusht**

Pas mbylljes së VV, KVV zbaton procedurat e njëjta, siç përcaktohen në nenin 18 të kësaj Rregulloreje, për zarfet e fletëvotimeve me kusht. Veprime të tjera rregullohen në procedurën

e miratuar nga KQZ.

## **Neni 20**

### **Procedurat pas numërimit të fletëvotimeve**

1. Pas përfundimit të numërimit të fletëvotimeve, sipas nenit 18 dhe 19 të kësaj Rregullore, kryesuesi i KVV:
  - 1.1. Lejon vëzhguesit e akredituar të pranishëm të marrin informata nga FPR dhe FRK, nëse e kërkojnë një gjë të tillë;
  - 1.2. publikon kopjen e FPR dhe FRK në QV;
  - 1.3. liron anëtarët e KVV dhe i njofton se mund të kontaktohen nga KKZ.
2. Në pajtim me udhëzimet e KKZ, kryesuesi i KVV dorëzon materialin zgjedhor nën përcjelljen e policisë në KKZ. Kryesuesin mund ta shoqërojë një apo më shumë anëtarë të KVV.
3. Nëse KKZ identifikon gabimet që lidhen me paketimin ose numërimin e materialeve të ndjeshme, KKZ mund të ndërmarrë çfarëdo mase korrigjuese, përfshirë këtu urdhërimin e paketimit ose të përputhjes së sërishme të zarfeve të fletëvotimeve me kusht, në prani të kryesuesit të KVV. Asnjë rinumërim i fletëvotimeve të rregullta nuk mund të bëhet nga KKZ. KKZ shënon korrigjimet në formularët me laps me ngjyrë tjetër nga ajo që është përdorur nga KVV. Krahas këtyre ndryshimeve, anëtari i KKZ shënon numrin identifikues të KQZ dhe inicialet e tij/saj.
4. Nëse paketimi i serishëm i materialeve është i nevojshëm, KKZ mbyllë pakot e reja në prani të kryesuesit të KVV dhe shënon numrin/at e ri të shiritit mbyllës në FPR gjegjëse, me laps me ngjyrë tjetër nga ajo që është përdorë nga KVV.
5. Pas përfundimit të procedurave sipas paragrafëve 2, 3 dhe 4 të këtij neni, kryesuesi i KVV lejohet të lëshojë hapësirat e KKZ, me leje të KKZ.
6. Anëtarët e KKZ shënojnë në version elektronik të gjitha rezultatet nga FPR, dhe ia dërgojnë KQZ, në pajtim me udhëzimet e dhëna nga koordinatori i terrenit të KQZ.

## **Neni 21**

### **Votimi dhe numërimi në vendvotime për raundin e dytë të zgjedhjeve**

Procedura e votimit dhe numërimit në VV për raundin e dytë, rregullohen në përputhje me nenin 14, 15, 16, 17, 18,19 dhe 20 të kësaj Rregullore.

**Neni 22**  
**Dorëzimi nga KKZ në QNR**

KKZ dorëzon materialet në QNR, në pajtim me Rregulloren Nr.14/2023, për QNR.

**Neni 23**  
**Ankesat**

1. Ankesat përkitazi me procesin e votimit dhe numërimit në VV, duhet të dorëzohen në PZAP brenda 24 orëve nga mbyllja e VV. PZAP vendos brenda 72 orëve pas pranimit të Ankesës, në pajtim me nenin 119.1 të LZP, nenin 28 të LZL dhe Rregullat e punës së PZAP.
2. Ankesa nuk pezullon procesin e numërimit.
3. Anëtari i KKV ka të drejtë të shpreh vërejtjet apo komentet e tij për procesin e numërimit dhe të rezultateve, sipas nenit 11 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 11/2023, për KVV.

**Neni 24**  
**Zbatimi**

1. KQZ, miraton procedurën për zbatimin e kësaj Rregullore.
2. Për zbatimin e kësaj Rregullore, KQZ organizon trajnimin e KKZ, KVV dhe stafin e QV.
3. KQZ do të përgatitë pako informuese për vëzhgues.

**Neni 25**  
**Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla zgjedhore Nr. 09/2013 votimi dhe numërimi brenda vendvotimeve në nivelin e komisionit komunal zgjedhor.
2. Pjese përbërëse të kësaj Rregullore janë shtojcat:

shtojca I - FPR- zgjedhjet parlamentare;  
shtojca II - FPR- zgjedhjet për kuvendin komunal;  
shtojca III- FPR- zgjedhjet për kryetar komune;  
shtojca IV FRK - formularin e rezultateve të kandidatëve;  
shtojca V FPR- zgjedhjet për kryetar komune – raundi i dytë.

**Neni 26**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

**Kryesues**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

---

**Kreshnik Radoniqi**